

RAPORT PER AUDITIMIN E FONDEVE TE SHPENZUARA NGA PARTIA
SOCIALISTE E VERTETE 91, NE FUSHATEN E ZGJEDHJEVE VENDORE
TE DATES 21 QERSHOR 2015

DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

TIRANE

Une, Qani Kajo, Ekspert Kontabel i Regjistruar, me licence profesionale nr.076 date 20.03.2000 dhe Nipt K37810309H, ne baze te kontrates se sherbimit nr.7750 date 05.10.2015, te lidhur me KQZ, me objekt “Auditimi i fondeve te shpenzuara prej Partive Politike, qe moren pjese ne fushaten e zgjedhjeve vendore te dates 21.06.2015”, kam nderin t`ju paraqes raportin e auditimit per Partine Socialiste te Vertete 91.

Auditimi u krye ne baze te ligjit 8580 date 17.02.2000 “Per Partite Politike”, i ndryshuar me ligjin 10374 date 10.02.2011. Gjitashtu auditimi u krye ne baze te ligjit 10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontablit te Miratuar” si dhe ligjit 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Auditimi kryhet gjithashtu , ne baze te vendimit nr.969 date 10.08.2015 te KQZ-se sipas shortit te hapur.

Duke u mbeshtetur ne bazen ligjore te mesiperme, une, auditova fondet e shpenzuara nga Partine Socialiste te Vertete 91, me kyetar zotin Petro Koci.

Per kete qellim mora kontakt me kryetarin e Partise dhe finacierin e kesaj partie, hartuam aneks kontraten per kryerjen e auditimit dhe u krijuan te gjitha kushtet per kryerjen e ketij auditimi pa asnje pengese.

Kryetari i Partise deklaroi se kishte marre fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit sipas ndarjes se bere. Fonde nga donator, subjekte juridike dhe individe, nuk kishin pasur per fushate.

Gjthesej ne llogarite e Partise kishin hyre nga buxheti i shtetit shuma **788.692** leke. Partia per fushaten e zgjedhjeve kishte bere shpenzime te ndryshme per; shpenzime

per ditën e fushatës, fonde të cilat i kishte shpërndarë nëpërmjet kordinatorëve , për komisionerët dhe vezhguesit në qendrat e votimit, shpenzime për flamuj, për postera të ndryshëm, banderola, flete votimi treguese, parrulla, printime në adeziv, për kandidatët në garë dhe për votuesit e Partisë, shpenzime për publicitet në media dhe shpenzime të vogla për koktejlë, duke bërë shpenzime të ndryshme për elektoratin.

Te gjitha shpenzimet e kryera ishin bërë me dokumenta të rregullta që plotësonin kushtet e ligjshmerisë tatimore, fatura të biznesit vogël me likuidim në banka sipas procedurave tatimore.

Në rasi të këtij subjekti këto shpenzime nuk përbenin materialitet për të deformuar gjendjen e administrimit.

Opinion

Sipas opinionit të auditit, Partia Socialiste e Vertetë 91, ka zbatuar kërkesat e ligjit 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar me ligjin 10374 datë 10.02.2011, për përdorimin e fondeve të përfituara nga buxheti i shtetit, për fushatat e zgjedhjeve.

Une si audit, duke u bazuar në kërkesat e ligjit për auditimin dhe në të gjitha ligjet në fushën e tatimeve dhe të mbajtjes së kontabilitetit, gjykoj se Partia Socialiste e Vertetë 91, ka zbatuar të gjitha rregullat për të përdorur drejt fondet e dhëna nga buxheti.

Ky raport i auditimit hartohet në tre kopje si dhe në format elektronik dhe mund të përdoret për gjithë të interesuarit.

Ekspert Kontabel I Regjistruar

Qani KAJO

Rruga “Hamid Shijaku” Pall. Protial

Nr.kontakti Mob 0692070915